



Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** e Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe nenit 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 10/03, prill 2019), dhe të nenit 33.2, shkronja **a**, dhe nenit 34.1, shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.02.2020, merr këtë

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Xhavit (Isa) Vllasaliut.
- II. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika: pjesë e parcelës kadastrale nr. 00501-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00501-0, Zona kadastrale Çagllavicë, pjesë e parcelës kadastrale nr. 00502-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00502-0, Zona kadastrale Çagllavicë, pjesë e parcelës kadastrale, nr. 00503-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00503-0, pjesë e parcelës kadastrale, nr. 00518-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00518-0, Zona kadastrale Çagllavicë, pjesë e parcelës kadastrale, nr. 00522-0, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914075-00522-0, me sipërfaqe prej 8893m².
- III. Prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale, nr. 00813-4, Certifikata e pronësisë, nr. P-71914050-00813-4, Zona kadastrale Matiçan, në pronësi të Xhavit (Isa) Vllasaliut, ne baze te Planit Rregullues "Mati 1" dhe "Prishtina e Re - Zona Qender" me destinim per Qender te Kujdesit Shendetesor dhe Qender te kujdesit te fëmijëve, ne te cilën është realizuar interesi publik, gjegjësisht është ndërtuar Qendra e Mjekësisë Familjare Mati1.
- IV. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë sepse Komuna e Prishtinës në këtë parcelë ka ndërtuar objektin e Qendrës së Mjekësisë Familjare, "Mati 1".
- V. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- VI. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
- VII. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.

VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

IX . Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-464/01-33129/20, më 10.02.2020

KRYESUESI I KUVENDIT
Agim Kuleta

